



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Kthim pergjigje

Enxhi Toska <enxhi.toska@infrastruktura.gov.al>

Thu, Nov 17, 2022 at 11:41 AM

To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Cc: Viola Haxhiademi <Viola.Haxhiademi@infrastruktura.gov.al>, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale <info@idp.al>

Pershendetje,

Në përgjigje të kërkesës si dhe ankimit nr. 1858 Prot., date 28.10.2022, të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, lidhur me ndërtimin/rehabilitimin e Hekurudhës Tiranë -Rinas – Durrës, ju informojmë si më poshtë vijon:

1. Kontrata e Punimeve është nënshkruar më datë 3 shkurt 2021 dhe “commencement of Works-fillimi i punës” ka qenë data 11 Mars 2021. Kjo datë quhet dita “zero” e nisjes së Kontratës/Punimeve. Kontraktori i Punimeve “INC spa” ka nisur rregullisht kontratën (më 11 Mars 2021) dhe ka kryer të gjitha obligimet kontraktuale në lidhje me fazën e parë, Projektin e Detajuar inxhinierik si edhe aktivitete të tjera kontraktuale (ngritja e kantierit, mobilizimi, parapagesa, sondazhet arkeologjike, sondazhet inxhinierike, topografike & gjeologjike, stafimi i ekipit, kualifikimet tek klienti dhe supervizori, miratimi i materialeve ndërtimore dhe pajisjeve elektro-mekanike, etj)

Projekti për rehabilitimin e Hekurudhës Tiranë-Durrës aktualisht ndodhet në fazën e rehabilitimit të linjës ekzistuese Durrës-Tiranë, ritmet e zbatimit të punimeve duhet theksuar që kanë qenë relativisht të larta gjatë periudhës Janar – Shtator 2022, ku deri më sot janë realizuar 30% të punimeve ndërtimore (fizikisht në terren), ndersa të certifikuarat me pagesa janë 17%.

2. Punimet do të përfundohen më datë 01 Mars 2024.

3. Sipas kontratës, kohëzgjatja e saj ishte **912 ditë** dhe ishte e ndarë në 3 faza, si më poshtë:

- Përgatitja e Projektit 6 Muaj
- Ndërtim 20 Muaj
- Testim 4 Muaj

Me nënshkrimin e Amendimit të sipërpërmendur është aprovuar një shtesë në kohë prej **174 ditësh**, për fazën e Ndërtimit, duke e çuar kohëzgjatjen totale të projektit në **1086 ditë**.

Data e Fillimit të punimeve **11/03/2021**

Data e parashikuar e Përfundimit të punimeve **10/09/2023**

Data e rishikuar e Përfundimit të punimeve **01/03/2024**

4. Lidhur me risqet e parashikuara për këtë projekt, ju informojmë se janë prerë të gjitha policat e sigurimit (CAR Policy (Contractor All Risk Policy)) nga ana e kontraktorit, sipas të gjitha parashikimeve kontraktuale dhe legjislacionit në fuqi.

Faleminderit për mirekuptimin!